



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:068602

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05745291

**P. nr.42/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, duke vendosur lidhur me pranimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me Nd.nr.17/2024, të datës 14.05.2024, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.235/2024, të datës 28.02.2024 kundër të akuzuarit E.(S.) H. nga M., Rr. "I.", për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par.3 nën par. 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, jashtë seancës e në mbështetje të nenit 357 par. 1 nën par. 1.3 të KPP-së, dhe nenit 2 par. 2, 8, 15 par. 1 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), **më 24 maj 2024, nxjerri këtë:**

## **A K T V E N D I M**

**I. MIRATOHET** marrëveshja me numër Nd.nr.17/2024, të datës 14.05.2024 e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në M., ndërmjet të akuzuarit **E. (S.) H.** nga Malisheva, për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par.3 nën par. 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe të dëmtuarës së mitur S. K., së bashku me përfaqësuesin e saj ligjor L. K., nga fshati Ll., Komuna e Malishevës, në anën tjetër.

**II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.235/2024, të datës 28.02.2024.

**III. PUSHOHET** procedura penale kundër të akuzuarit E.(S.) H., për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par.3 nën par. 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

**IV.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë/ Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën, PP/II.nr.235/2024, të datës 28.02.2024, kundër të akuzuarit E.(S.) H. nga M., për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par.3 nën par. 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata më 03.04.2024, e ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale dhe me pajtimin e palëve në procedurë e duke vepruar në bazë të nenit 8 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Institutin për Ndërmjetësim në Malishevë.

Më 14.05.2024, në Qendrën për Ndërmjetësim në Malishevë, është arritur marrëveshja Nd.nr.17/2024, në mes të palëve në procedurë. Andaj gjykata duke vepruar në bazë të dispozitës së nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovojë këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi. Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësimin më datën e pranimit nga gjykata përkatësisht nga data **24 maj 2024**, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u morën në bazë të nenit 453 par.1 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë dhe konform nenit 357 par. 1 nën par. 1.3 të KPP-së, e lidhur me nenin 2,15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË**

#### **DEPARTMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**

**P.nr.42/2024, më 24 maj 2024**

**Bashkëpunëtori profesional,  
Samir MORINA**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Njazi MORINA**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.